



ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Ri-Shqyrtim të dt. 04.12.2020 nga Operatori Ekonomik "LIRIA" SHPK Podujevë, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit "Blerja e makinave për pastrim dysHEMEJE dhe makina për prerje bari" me Numër të Aktivitetit të Prokurimit 615-20-6852-1-2-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

Aprovohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e dt. 04.12.2020, lidhur me ankesën parashtruar nga OE "LIRIA" SHPK Podujevë, në aktivitetin e prokurimit " Blerja e makinave për pastrim dysHEMEJE dhe makina për prerje bari " me nr. të Prokurimit: 615-20-6852-1-2-1.

- Aktiviteti i prokurimit të pezullohet dhe lënda të kthehet dhe njëhere në rivlersim.

Arsyetim

AK, Komuna e Podujevës pas shqyrtimit të kërkesës së OE "LIRIA" SHPK Podujevë, parashtruar kërkesën duke kërkuar nga AK - Komuna e Podujevës që ta aprovoj kërkesën për rishqyrtim dhe të kthej lëndën në Rivlerësim.

AK, Komuna e Podujevës ka analizuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka aprovuar si pjesërisht të bazuar dhe vlerëson që aktiviteti i cekur i prokurimit të kthehet edhe një here në rivlerësim.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në OSHP.

Nr. 14-370/01-0074877 /ko
Podujevë,
09.12.2020

Menaxheri i ZP
Rasim Fejza

